

# FINANCA

Ditari Mujor | Gusht 2024

## KËSHILLI I MINISTRAVE MIRATON RISHIKIMIN E BUXHETIT 2024, TË ARDHURAT RRITEJEN ME 27 MILIARDË LEKË

Këshilli i Ministrave miratoi rishikimin e buxhetit të vitit 2024. Në komunikimin pas mbledhjes së qeverisë, Ministri Petrit Malaj informoi se rishikimi është bërë nga Ministria e Financave si rezultat i performancës pozitive në realizimin e të ardhurave nga tatimet, doganat, qeverisja vendore, si dhe të ardhurat jo tatimore.

Ministri tha se të ardhurat e parashikuara janë rritur me 27 miliardë lekë, ndërkohë që do të shpërndahen në sektorë me ndikim të lartë social dhe që kontribuojnë më shumë në zhvillimin ekonomik të vendit. Z.Malaj përmendi disa nga financimet shtesë, si ato në masën 500 milionë lekë për Ministrinë e Bujqësisë,

për mbështetjen e skemës së granteve të fermerëve; financimi shtesë prej 250 milionë lekë për Ministrinë e Shëndetësisë në mënyrë që të financohen projekte të shërbimit të kujdesit parësor dhe dytësor; financimi shtesë për Ministrinë e Brendshme në vlerën rreth 1.3 miliard lekë për kompensimin ushqimor të Policisë; si dhe fondet shtesë për Ministrinë e Arsimit dhe të Sportit me vlerën 300 milionë lekë për shpërblimin e sportistëve që kanë arritur rezultate të mira sportive.



## MINISTRI I FINANCAVE INSPEKTON ZONËN E LIRË DOGANORE NË PORTO ROMANO

Ministri i Financave, Petrit Malaj, zhvilloi një vizitë pune në zonën e lirë doganore në Porto Romano, i shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Z. Genti Gazheli. Qëllimi i kësaj vizite ishte inspektimi në terren i zbatimit të Planit Operacional për monitorimin e zinxhirit furnizues të karburanteve, që nga importi, depozitat në zonën e lirë doganore, shitjes me shumicë dhe shitjen në pikat e furnizimit me pakicë. Plani

po zbatohet nga Administrata Doganore, ajo Tatimore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, në mënyrë të koordinuar për 24 orë në ditë. Ministri i Financave theksoi rëndësinë e monitorimit të zinxhirit furnizues të karburanteve dhe kërkoi angazhimin maksimal të tre institucioneve për zbatimin e masave të parashikuara në Planin Operacional.

LEXO MË SHUMË

### TË ARDHURAT TOTALE



## Performanca Paraprake e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për 7-mujorin 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Korrik 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 7-mujore arritën në rreth 402,51 miliardë lekë ose 103% e planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mbledhën rreth 30,350 miliardë lekë më shumë ose 8.2% më shumë se 7 mujori i vitit 2023. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 7 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 347.5 miliardë lekë me një realizim në masën 92.3% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ky zë ka rezultuar 6.3% më i lartë ose rreth 20.5 miliardë lekë më shumë. Shpenzimet korente për periudhën 7 mujore të vitit 2024 rezultuan në rreth 314.7 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 8.5 përqind më i lartë ose rreth 24.8 miliardë lekë më shumë.

LEXO MË SHUMË

## Ministri Malaj takohet me drejtues të Administratës Tatimore dhe Doganore



Ministri i Financave, Petrit Malaj, zhvilloi një takim me drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi ecurinë e realizimit

të objektivave nga këto dy institucione të varësisë të Ministrisë së Financave. Ministri Malaj theksoi rëndësinë e intensifikimit të punës në mënyrë që të përmbushen me efikasitet prioritetet e përcaktuara, duke sjellë në vëmendje se planifikimi buxhetor, bazuar në mbledhjen e të ardhurave, duhet t'i përgjigjet vijimit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Mirë planifikimi nga Ministria e Financave dhe realizimi i objektivave nga strukturat e administratës tatimore dhe doganore do të jenë çelësi i suksesit dhe qëndrueshmërisë financiare që pritet në vazhdimësi nga qeveria shqiptare.

LEXO MË SHUMË

## Ministri Malaj takohet me Të Ngarkuarën me Punë të SHBA znj. Nancy VanHorn



Ministri i Financave priti në një takim Të Ngarkuarën me Punë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, znj. Nancy VanHorn, me të cilën diskutoi mbi marrëdhëniet dypalëshe dhe ecurinë e bashkëpunimit

mes qeverisë shqiptare dhe SHBA-ve. Palët theksuan partneritetin strategjik mes dy vendeve, i cili shënon një të ardhme premtuese për marrëdhëniet ekonomike në rritje. Ministri Malaj shprehu mirënjohjen ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e reformave kryesore të ndërmarra nga qeveria shqiptare dhe përparimit të Shqipërisë sa i përket integritimit në BE, mbështetje e cila kontribuon drejtpërdrejt në rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Ministri i Financave tha se qeveria shqiptare mirëpret rritjen e prezencës së investitorëve amerikanë dhe nxiti kompanitë amerikane të investojnë në sektorët prioritarë të ekonomisë shqiptare.

LEXO MË SHUMË

## Ministri Malaj në Konferencën e Ambasadorëve, diskutime mbi diplomacinë ekonomike

Ministri i Financave mori pjesë në punimet e Konferencës së Ambasadorëve, ku ishte pjesë e panelit të diskutimeve mbi diplomacinë ekonomike. Në fjalën e tij, Ministri Malaj theksoi rëndësinë e diplomacisë ekonomike për avancimin e vendeve në interesat e tyre ekonomike dhe kombëtarë, si dhe intensifikimin e partneriteteve tregtare. Z. Malaj tha se Shqipëria është një vend tërheqës për investimet e huaja dhe përfaqësitë diplomatike e kanë më të lehtë të promovojnë vendin, pasi falë politikave të ndërmarra ekonomia shqiptare konsiderohet nga më rezistentet në rajon. Sipas Ministrisë, duhet një angazhim më proaktiv nga përfaqësitë diplomatike dhe një komunikim sa më i mirë mes institucioneve dhe trupës diplomatike, në funksion të tërheqjes së investimeve të huaja dhe rritjes së shkëmbimeve tregtare mes vendeve.

LEXO MË SHUMË



## Ministri Malaj takohet me ambasadorin e Gjermanisë dhe drejtoreshën e KfW



Ministri i Financave priti në një takim ambasadorin e Gjermanisë në Tiranë, z. Karl Bergner, së bashku me drejtoreshën e Bankës për Zhvillim KfW në Shqipëri, znj. Brit Horschke, me të cilën bisedoi mbi forcimin e mëtejshëm

të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Gjermanisë. Ministri Malaj vlerësoi faktin se Gjermania është një partner strategjik për vendin tonë dhe mbështetëse nëpërmjet financimeve direkte e një sërë projekteve në sektorë prioritarë. Në këtë kuadër, Ministri i Financave theksoi se miradministrimi financiar i fondeve nga partnerët ndërkombëtarë dhe ndjekja me rigorozitet e proceseve janë të rëndësishme për vazhdimësinë e zbatimit të projekteve të përbashkëta. Gjatë takimit u diskutua edhe mbi vijimin e bashkëpunimit me KfW.

LEXO MË SHUMË

## Ministri Malaj takohet me Ambasadorin e Italisë Fabrizio Bucci



Ministri i Financave priti në një takim Ambasadorin e Italisë në Tiranë, z. Fabrizio Bucci, me të cilin bisedoi mbi ecurinë e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Italisë. Ministri theksoi faktin se Italia vijon të

jetë një nga partnerët më të mëdhenj tregtarë të Shqipërisë dhe burimi kryesor i investimeve të huaja direkte në sektorin bankar, energji, prodhim dhe ndërtim. Ministri i Financave shprehu falënderimet e veçanta për nënshkrimin e marrëveshjes për pensionet dhe papunësinë mes Shqipërisë dhe Italisë, si dhe angazhimin për bashkëpunim të mëtejshëm përsa i përket ekspertizës teknike për harmonizimin dhe përafrimin e legjislacionit tonë me direktivat e Bashkimit Evropian.

LEXO MË SHUMË